

Nr. Rendor	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfundimit të kërkesës	Tarifa
1	26.01.2024	Kërkesë për informacion - Sa automjete rezultojnë debitor që nuk kanë paguar taksën për vitin 2023? 2. Sa është numri aktual i automjeteve që rezultojnë debitor në total për gjatë gjithë viteve, borxh i cili është akumuluar? 3. Sa është shume e borxhit që është akumuluar gjatë vitit 2023? 4. Sa është shuma aktuale në total e borxhit që kanë automjetet ndaj DPSHTRR? 5. Cilat janë kategoritë e automjeteve që rezultojnë debitor? 6. Për çfarë lloj detyrimesh rezultojnë debitor kryesisht automjetet?	07.02.2024	Referuar kërkesës me email protokolluar me Tonën nr. 1808, datë 26.01.2024 në lidhje me debitorët e taksave të mjeteve, ju informojmë se nga evidencat e gjeneruara nga Regjistri i Debitorëve në sistemin informatik eDPSHTRR, rezultojnë këto të dhëna: VITI DEBITOR/ NUMRI TOTAL I MJETEVE DEBITORE 2013 9,174 2014 11,369 2015 10,053 2016 11,941 2017 12,309 2018 11,783 2019 12,848 2020 12,635 2021 15,300 2022 25,743 2023 82,744 TOTAL 215,899 Në këto evidence rezultojnë të përfshira të gjithë kategoritë e mjeteve, nga L1 deri në O4. Përsa i përket informacioneve të kërkuara në lidhje me vlerën totale në lekë të akumuluar të debitorëve ndër vite, kjo është një e dhënë e cila nuk mund të përlogaritet saktë, pasi është dinamike dhe e ndryshueshme për çdo ditë për çdo mjet, në varësi edhe të vlerave të gjobave të gjeneruara për vonesë në pagesën e taksave. Bazuar në ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008 "Për Taksat Kombëtare", i ndryshuar, si dhe në zbatim të Udhëzimit të Ministrit së Financave nr. 26, datë 04.09.2008 "Për Taksat Kombëtare", i ndryshuar, përcaktohet se Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor është agjent për llogaritjen, arkëtimin dhe transferimin në llogarinë e Buxhetit të Shtetit të të ardhurave nga taksat e mjeteve. Për këtë arsye, DPSHTRR njeh si debitor mjetet që nuk kanë paguar taksën vjetore të mjeteve të përdorura (TVMP) dhe taksën vjetore të mjeteve të luksit (TVML).	E plotë	0
2	02.02.2024	Kërkesë për informacion - 1. Kush do të konsiderohet mjet luksoz? Cfarë kriteresh duhet të ketë një makinë që të konsiderohet luksoz? 2. Në këtë fazë pilotimi, sa është numri i mjeteve që do të përfshihen fillimisht? 3. Në çfarë faze është puna deri më tani për të nisur këtë projekt? 4. Sa është numri i makinave luksoze të regjistruara aktualisht në vendin tonë?	13.02.2024	Referuar kërkesës tuaj me email protokolluar me Tonën nr. 2431, datë 05.02.2024 në lidhje me debitorët e taksave të mjeteve, ju informojmë se bazuar në ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008 "Për Taksat Kombëtare", i ndryshuar, si dhe Udhëzimin e Ministrit së Financave nr. 26, datë 04.09.2008 "Për Taksat Kombëtare", i ndryshuar, përcaktohet se: "Automjet luksoz" konsiderohet autovetura deri në 6+1, e cila plotëson të paktën njërin nga kushtet e mëposhtme: a) cilindratën të barabartë ose më të madhe se 3000 cm3; ose b) vlerën/çmimin të barabartë ose më shumë se 5 000 000 lekë. Vlera e mjetit, për efekt të klasifikimit "Automjet luksoz", reduktohet (amortizohet) jo më shumë se 10% të vlerës së mbetur çdo vit, duke marrë si vlerë fillestare për efekt reduktimi (amortizimi) vlerën e fundit të regjistruar në sistem." Nga evidencat e gjeneruara nga Regjistri Kombëtar i Mjeteve më 31.12.2023 rezultojnë se me status aktiv janë 21,814 automjete luksoze, nga të cilat 3,668 automjete kategorizohen luksoze prej plotësimit të kushtit për vlerën, ndërkohë 18,146 automjete prej cilindratës. Përsa i përket pyetjeve të tjera, ju mund t'i drejtoheni Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për një informacion më të detajuar.	E plotë	0
3	04.03.2024	Kërkohet informacion	06.03.2024	Në përgjigje të kërkesës tuaj, datë 01.03.2024, protokolluar në DPSHTRR me Nr. 4506 Prot., datë 04.03.2024, me atë të cilës kërkoni informacion lidhur me mjetin tuaj, lutemi paraqituni pranë DRSHTRR-së Tiranë, për të kryer azhormimin e lejes së qarkullimit, duke dorëzuar lejen e qarkullimit dhe certifikatën e pronësisë së mjetit.	E plotë	0
4	18.03.2024	Kërkesë për informacion	25.03.2024	Në përgjigje të kërkesës tuaj ku kërkoni informacion, në zbatim të nenit 35 të ligjit Nr. 8308, datë 18.03.1998 "Për Transportet Rrugore", i ndryshuar, licenca për shërbimin taksit jepet nga kryetari i bashkisë përkatëse, në përputhje me rregullat e përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave. Për sa më sipër DPSHTRR nuk është kompetente për lëshimin e licencave të shërbimit taksit. Nga verifikimi në sistemin elektronik e-dpshttr, rezulton se mjeti me targë xxxxxxx është në qeramarrje nga subjekti XXXXXXXX në nipt përkatës.	E pjeshme	0

5	20.03.2024	Kërkesë për informacion	25.03.2024	<p>Në vijim të email-it dërguar nga ana Juaj, ku deklaroni se keni shitur mjetin:</p> <p>Për sa keni kërkuar se nga ana Juaj, në zbatim të Udhëzimit i MIE Nr. 4, datë 28.6.2019, duhet të kryeni procedurën për rastet kur mjeti është shitur dhe blerësi nuk është paraqitur për të kryer veprimet e ndryshimit të pronësisë pranë DRSHTRR-së dhe ka kaluar afati 30 ditë nga data e ndryshimit të pronësisë.</p> <p>Shitësi mjetit paraqitet në DRSHTRR-në ku ndodhet dosja e mjetit, plotëson deklaratën e marrjes së përgjegjësisë dhe dorëzon:</p> <p>dokumentet identifikues, që i japin të drejtën për të kryer shërbim;</p> <p>dokumentin e fitimit të pronësisë nga blerësi, në origjinal ose të njesuar me origjinalen.</p> <p>Nga DPSHTRR-ja përgatit shkresat zyrtare për të njoftuar blerësin, Drejtorinë Vendore të Policisë së Qarkut dhe për të vënë në dijeni Drejtorinë e Policisë Rrugore në DPPSH.</p> <p>Bazuar në pikën 1, të nenit 12, të ligjit nr. 33/2017 "Për pagesën dhe fshirjen/shuarjen e detyrimeve tatimore, detyrimeve të pagueshme në doganë, si dhe procedurën e heqjes nga qarkullimi të mjeteve të transportit pas fshirjes /shuarjes së detyrimeve tatimore" citohet se:</p> <p>Përveç sa parashikohet në këtë ligj, në përputhje me përcaktimet, sipas këtij neni, hiqen nga qarkullimi të gjitha mjetet e regjistruara në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor, për të cilat nuk është kryer asnjë veprim me këto mjete pas datës 31 dhjetor 2011 e në vijim.</p> <p>Për sa më sipër, duke qenë se për mjetin me targë XXXXXXXX janë paguar taksat për herë të fundit më datë 04.06.2012, ndaj këtij mjeti nuk aplikohet procedura e heqjes nga qarkullimi.</p> <p>Për këtë arsye mjeti mban statusin Aktiv në Regjistrin Kombëtar të Mjeteve dhe është debitor për taksat nga viti 2013 me një vlerë totale prej 145,821 lekë.</p>	E plotë	0
6	21.03.2024	Kërkesë për informacion	26.03.2024	<p>Lidhur me kërkesën tuaj ju bëjmë me dije se për sa i përket subjekteve që kryejnë ndërhyrje në mjete si më poshtë:</p> <p>Reklama dhe Sinjalistika;</p> <p>Printime, Veshje Makinash;</p> <p>Artikuj promoocionale;</p> <p>Sherbime Dizajni.</p> <p>Këto subjekte duhet të pajisen me licencë nga QKB me kod:</p> <p>1. VII.3.B.1/b (RIPARIM DHE MIRËMBAJTJE KARROCERIE) ;</p> <p>2. VII.3.B.1/c (RIPARIM DHE MIRËMBAJTJE IMPJANTI ELEKTRIK).</p>	E plotë	0